



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prenheno/Prodato Received/Delivered	13-03-2023	3	viti god year
Organ /Bjesta Organ /Jedinstvo Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shifra Protog Appendix	Sasia Kolicitimi Quantity
SKAMSHICK	2593/2023		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.307/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.307/2023 të datës 02.02.2023 të parashtruar nga ankuesi _____, kundër organit të punësimit/Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 13.03.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.307/2023 e datës 02.02.2023 e parashtruar nga ankuesi _____.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil _____ i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, më datë 02.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1249/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me shkrim të datës 18.01.2023 të organit të punësimit/Zyrës së Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit për kompensimin e mjeteve financiare në mënyrë retroaktive në emër të diferencës së koeficienti të pagës nga gjashtë (6) në tetë (8) nga hyrja në fuqi e ligjeve të miratuara nga institucionet e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 15.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Ndërsa Këshilli, me datë 08.03.2023 përmes emalit ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1249/2023 të datës 02.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë të datës 18.01.2023 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut; Përgjigjen e datës 18.01.2023 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut lidhur me refuzimin e përgjigjes në kërkesë të datës 21.12.2022 të ankuesit; Ndryshim Plotësimin e Akt emërimit nën shenjë A.E.NR.01-112/01-0107815/22 të datës 03.12.2022; Akt emërimit të datës 14.02.2013; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.02.2023; përgjigjen e datës 08.03.2023; Kërkesën e datës 21.12.2022 të parashtruar nga ankuesi të Menaxheri i Burimeve Njerëzore;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut në pozitën e punës Inspektor i Tregut. I njëjti më datë 05.10.2022 kishte parashtruar ankesë për harmonizimin e koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në koeficientin tetë (8), në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.866/2022 të datës 18.11.2022 ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar dhe ka obliguar organin e punësimit që ankuesit t'ia harmonizoj koeficientin e pagës me titullin e pozitës dhe përshkrimin e vendit të punës, nga gjashtë (6) në tetë (8), ku si rrjedhojë organi i punësimit, respektivisht Komuna e Mitrovicës së Jugut, më datë 03.12.2022 ankuesit i ka lëshuar Akt Emërimit A.E.Nr.01-112/01-0107815/22 më koeficient tetë (8).

Ankuesi më datë 21.12.2022 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut për kompensimin retroaktiv të diferencës së koeficientit për periudhën nga janari 2015 e tutje. Udhëheqësi i Personelit përmes përgjigjes së datës 18.01.2023 ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 21.12.2022 me arsyetimin se koeficienti i pagës tetë (8) do të vlejë vetëm nga data e zbatimit të vendimit të Këshillit.

I pakënaqur me përgjigjen e datës 18.01.2023 të organit të punësimit, ankuesi me datë 02.02.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e diferencës së një koeficienti të pagës në mënyrë retroaktive nga janari 2015 e tutje.

Kolegji i Këshillit, shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin e diferencës së një koeficienti të pagës në mënyrë retroaktive, dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesi me datë 14.02.2013 ka nënshkruar pa vërejtje aktin e emërimit për pozitën e punës *Inspektor i tregut* me koeficient të pagës gjashtë (6), dhe se i njëjti edhe përkundër faktit se ka qenë në dijeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri me datë 05.10.2022, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohen kur ankuesi kishte nënshkruar aktin e emërimit me datë 14.02.2013), përkatësisht nenin 130 të këtij ligji ku përcaktohet se: 130.1. *Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.*

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.


KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.307/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së